



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA FUSHË KOSOVË



OPŠTINA KOSOVO-POLJE/MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DREJTORIA ZA ADMINISTRACIJU

Nr./No. 152
Data/Datum. 21. 01. 2026

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Gradonaçelnika
Mayor's Office

Datë: 21.01.2026

Në bazë të neni 13 dhe neni 58 të Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe neni 43 dhe neni 44 të Statutit Nr. 98 të datës 17.08.2012 të Komunës së Fushë Kosovës, ndërlidhur me neni 55 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor me ndryshimet dhe plotësimet e tij, si dhe bazuar në Aktin Administrativ Nr. 14-2/26 i datës 14.01.2026 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Vendimi Nr. 2496 të Kryetarit të Komunës të datës 26.12.2025, Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet Vendimi Nr. 2496 i Kryetarit të Komunës të datës 26.12.2025.
2. Në pikën 1 të Vendimit Nr. 2496 fjala anulim zëvendësohet me fjalën shfuqizim.
3. Pika 2 e Vendimit Nr. 2496 fshihet në tërësi.
4. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas vlerësimit të pajtueshmërisë ligjore nga organi administrativ i shkallës së dytë, Ministrisë së linjës përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes përgjigjes në kërkesë Nr. Prot. 14-2/26 i datës 14.01.2026 është konstatuar se pretendimet e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Projektim, të Komunës së Fushë Kosovës, janë të qëndrueshme për faktin se zbatimi i këtij vendimi në procedurat e dhënies së lejeve ndërtimore, nuk ka qenë në pajtueshmëri ligjore sipas ligjeve në fuqi. Konform Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinorë, nuk parasheh marrjen e vendimeve të kësaj natyre. Ndërlidhur me neni 36 i Udhëzimit Administrativ MMPH-24/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, nuk ka të bëjë me procedurat e shpronësimit por me propozim për ndryshimin plotësimin e Hartës Zonale të Komunës. Në kuadër të dispozitës ligjore në fuqi, përshkruhet procedura që duhet ndjekur për plotësim ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës dhe procedurat e përcaktuara nuk përputhen me vendimin në fjalë.

Neni 39 i UA MMPHI-24/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale është dispozitë ligjore që ka të bëjnë me Bonuse të Zonimit, kurse kjo çështje duhet të rregullohet me Rregullore dhe Komuna e Fushë Kosovës nuk ka një rregullore të tillë në fuqi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA FUSHË KOSOVË



OPŠTINA KOSOVO-POLJE/MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Gradonaçelnika
Mayor's Office

Kurse ndërlidhur me Ligji Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe ndryshim plotësimeve të këtij ligji, shpronësimi i pronës së paluajtshme lejohet vetëm për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik dhe vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve të përcaktuara me ligj.

Vendimi Nr. 641 i datës 14.06.2023, i shfuqizuar ka anashkaluar zbatimin e Ligjit Nr. 03.L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përkatësisht ka kufizuar te drejtën ligjore për kompensim financiar.

Gjithashtu, shtojmë se sipas neni 55 të paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimi Nr. 641 i shfuqizuar është konstatuar si i kundërligjshëm, i cili ka shkaktuar pasoja dobiprurëse me mirëbesim për palët si dhe palët e treta dhe si rezultat i kësaj, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të inicohet konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të këtij vendimi.

Valon Prebreza

Kryetar i Komunës



Akti dorëzohet:

- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Projektim
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
- Drejtorisë së Inspektoratit
- Departamentit Ligjor
- Arkivit të Komunës